



انمول ہیرے (Albanian)

DIAMANTE TË PAÇMUARA



Shejhi i Tarikat Ameer-e-Ehli Sunnet
Themeluesi i Daveti Islami Al-Ismi Maulana Abu Bilal

MUHAMMAD ILYAS

Attar Qadiri Razavi

کاتبِ موعظ
العلماء

انمول حیرے

Anmool Heeray

DIAMANTE TË PAÇMUARA

Kjo broshurë u shkrua në gjuhën urdu nga Shejhu i Tarikatit dhe themeluesi i Davet-i Islami, Hazreti Al-lama Muhamed Iljas Attar Kadiri Razavi دَامَنَتُ بَرَكَاتُهُوَ الْعَالِيَهُ. Kjo broshurë është përkthyer në shqip nga përkthyesi i departamentit të përkthimit (Davet-i Islami). Nëse konstatohet ndonjë gabim në përkthim, ju lutemi të kontaktoni përkthyesin e Mexhllisit (Dawat-i Islami) dhe do të shpërbleheni nga Zoti për të.

Translation Department (Dawat-e-Islami)

Aalami Madani Markaz, Faizan-e-Madinah Mahallah Saudagran,
Purani Sabzi Mandi, Bab-ul-Madinah, Karachi, Pakistan

UNA: ☎ +92-21-111-25-26-92 – Ext. 7213

Email: ✉ translation@dawateislami.net

الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ وَالصَّلَاةُ وَالسَّلَامُ عَلَى سَيِّدِ الْمُرْسَلِينَ
أَمَّا بَعْدُ فَأَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ط

Lutja e leximit të librit

Përpara se të lexoni një libër ose mësim fetar, lexoni lutjen e mëposhtme! Në këtë rast, gjithçka që lexoni do të mbetet në mendjen tuaj إِنْ شَاءَ اللَّهُ عَزَّ وَجَلَّ. Lutja është si vijon:

اللَّهُمَّ افْتَحْ عَلَيْنَا حِكْمَتَكَ وَأَنْشُرْ
عَلَيْنَا رَحْمَتَكَ يَا ذَا الْجَلَالِ وَالْإِكْرَامِ

Përktimi:

O Allah عَزَّ وَجَلَّ, na hap dyert e diturisë dhe urtësisë dhe na lësho mëshirën Tëndë! O i Madhërishëm dhe Falës!

(Mustaraf vëll 1 fq.6.Darulfikir Beirut)

Shënim: Lexoni Salat-u Selam një herë në fillim dhe një herë në fund.

Tabela e Përmbajtjes

Diamante të Paçmuara	1
Virtyti i Salavatit ﷺ	1
Diamante të paçmuara në jetën tonë.....	2
Jeta është e shkurtër	3
Vazhdimësia e frymëmarrjes	4
Njoftimi i ditës.....	4
I vdekur apo i gjallë!.....	5
Vdekja vjen papritur	5
Të jesh i trishtuar në xhennet!.....	6
Lutja (dhikri) që këndojmë kur mprehim lapsin.....	6
Mbill pemë në xhennet!.....	7
Virtyti i Salavatit.....	7
Më shumë se 60 vjet adhurim.....	8
Pesë gjëra para pesë gjërave	9
Dy mirësi	10
Bukuritë e Islamit	10
Vlera e momenteve të paçmuara.....	10

Çfarë thonë ata që vlerësojnë kohën.....	11
Bëni një plan kohor.....	13
Mirësitë e Mëngjesit.....	14
15 Lule të bukura lidhur me gjumin.....	16
Pasi ta lexoni këtë libër, jepjani dikujt tjetër.....	19

الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ وَالصَّلَاةُ وَالسَّلَامُ عَلَى سَيِّدِ الْمُرْسَلِينَ
أَمَّا بَعْدُ فَأَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Diamante të Paçmuara ¹

Pavarësisht se sa shumë shejtani ju tundon për dembelizëm, lexojeni këtë broshurë nga fillimi në fund. Ju do të përfitoni të mira të panumërta në jetën e përtejme, si dhe në jetën e kësaj bote
إِنْ شَاءَ اللَّهُ عَزَّوَجَلَّ

Virtyti i Salavatit ﷺ

Hazreti Alâ, Imam i Ehli Sunetit Mevlana Shejh Imam Ahmed Riza Khan رَحْمَةُ اللَّهِ عَلَيْهِ në Fatawa-i Razaviye vëllimi 23 faqe 122, transmeton si më poshtë: Ebul Mevahib رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ ka thënë; Unë e pashë Profetin tonë Muhamed në ëndërr. Kur Profeti Muhamed tha: “Ti do të ndërmjetësosh për njëqind mijë njerëz në Ditën e Gjykimit.” Dhe unë i thashë: “O i Dërguari i Allahut, si u bëra i denjë për këtë? I Dërguari i Allahut صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ tha: "Sepse ti dërgon shumë salavat dhe ato mi dhuron mua." (Aṭ-Ṭabqāt-tul-Kubrā lil SHarani f, q . 101)

Ky fjalim u mbajt gjatë takimit të mbushur me sunet dhe frymëzim të Dawat-e-Islami mbajtur në sarae Medinë më 25 nëntor 2010, Bāb-ul-Madina Karaçi, 1430 H – 2009. Shkruar me ndryshimet e nevojshme. [Maclis Mektebet-ul-Medina]

Diamante të paçmuara

Mënyra për të dhuruar sevapin: Kur dërgoni salavat, bëni njet në zemrën tuaj për të dhuruar sevapin. Pastaj me gjuhën tuaj thoni; Sevapin e këtij salavati ia kam dhuruar të Dërguarit të Allahut صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ.

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

Thuhet se një Sulltan kalon nëpër një vresht me shërbëtorët e tij. Ata panë që dikush po gjuante me gurë drejt vreshtit. Një nga gurët godet sulltanin. Sulltani urdhëron shërbëtorët e tij që ta kapin shpejt. E kapën dhe e sollën një të varfër. “Ku i gjetët këta gurë?” pyeti Sulltani. I varfëri; I pashë këta gurë kur isha duke u endur nëpër një shkretëtirë dhe më pëlqyen shumë. Kështu i mbusha xhepat me ta. Dhe teksa kaloja pranë këtij vreshti, më shkoi mendja të ha nga frutat e pemës që ishte këtu. “Kështu unë i përdora gurët për të hedhur frutat në tokë.” Sulltani tha; A e din vlerën e këtyre gurëve? I varfëri; Ai i tha jo, nuk e di. Sulltani i tha; “Këta janë diamante të paçmuara. Por ju i humbët këta për shkak të injorancës suaj.”

Diamante të paçmuara në jetën tonë

Të dashur vëllezër dhe motra! Po kështu, momentet e jetës sonë janë diamante të paçmuara. Nëse i shpenzojmë në aktivitete të padobishme, nuk do të përfitojmë gjë tjetër veç trishtimit dhe keqardhjes në ditën e gjykimit.

Allahu عَزَّوَجَلَّ i dërgoi njerëzit në botë për një periudhë kohore dhe qëllim të caktuar. Në ajetin 115 të sures Muminun thotë;

Diamante të paçmuara

أَفَحَسِبْتُمْ أَنَّمَا خَلَقْنَاكُمْ عَبَثًا وَأَنَّكُمْ إِلَيْنَا لَا تُرْجَعُونَ ﴿١١٥﴾

A menduat se Ne ju krijuam kot dhe se ju nuk do ktheheni te Ne?

(xhuzi 18, El-Mu`minūn, ajeti 115)

Në lidhje me këtë ajet, në Hazin-ul-Irfan është shkruar: “A nuk do të ringjalleni për gjykim ditën e gjykimit? Ju jeni krijuar për adhurim, i cili është i detyrueshëm për ju. Pasi të ktheheni te ne, do të shpërbleheni për punët që keni bërë.

Në lidhje me shpjegimin e qëllimit të krijimit të jetës dhe vdekjes, në ajetin 2 të sures El-Mulk thuhet si më poshtë:

لا

الَّذِي خَلَقَ الْمَوْتَ وَالْحَيَاةَ لِيَبْلُوَكُمْ أَيُّكُمْ أَحْسَنُ عَمَلًا

Ai është që krijoi vdekjen dhe jetën, për t'ju provuar se cili prej jush është më vepër mirë.

(xhuzi 29, sureja Mulk, ajeti 2)

Jeta është e shkurtër

Të dashur vëllezër myslimanë! Përveç këtyre dy ajeteve, qëllimi i krijimit të njeriut është shpjeguar edhe në shumë vende të tjera të Kuranit. Njeriu duhet të jetojë për një kohë shumë të kufizuar në këtë botë. Në këtë jetë të shkurtër, ai duhet të bëjë përgatitjet për varrin dhe ditën e gjykimit për një kohë të gjatë.

Diamante të paçmuara

Kjo është arsyeja pse koha që kemi tani është kaq e çmuar. Koha fluturon. As nuk mund të ndalet dhe as të merret nën kontroll. Pasi e nxjerrim frymën, ajo nuk kthehet më.

Vazhdimësia e frymëmarrjes

Hazreti Hasan Basriu رَحْمَةُ اللَّهِ عَلَيْهِ ka thënë: "Nxitoni! Nxitoni! A e dini se cili është realiteti i jetës - Jeta përbëhet nga frymëmarrja. Nëse ndalet ajo, ndalojnë edhe veprat tuaja. Me këto frymëmarrje i afrosh Allahut. Allahu i mëshiroftë ata që e mbajnë veten përgjegjës dhe derdhin lot për mëkatet e tyre. Pasi tha këtë, Hazreti Hasan Basriu رَحْمَةُ اللَّهِ عَلَيْهِ lexoi këto ajete, të sures Merjem, ajeti 84.

إِنَّمَا نَعُدُّ لَهُمْ عَدًّا

*Se Ne vetëm jemi duke ua numëruar atyre (jetën në ditë,
frymëmarrje etj.).*

(xhuzi 16, sureja merjem, ajeti 84)

Huxhxhetul-Islam Hazreti Imam Muhamed Bin Muhamed Gazali رَحْمَةُ اللَّهِ عَلَيْهِ thotë: 'Ky numërim shpreh numrin e frymëmarrjeve.' (*Ihyā-ul-'Ulūm, vëll. 4, fq. 205*)

Njoftimi i ditës...

Hazreti Imam Bejhakiu رَحْمَةُ اللَّهِ عَلَيْهِ në Shi'bul iman citon si vijon: Profeti ynë صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ ka thënë: "Çdo ditë, në lindjen e diellit, dita thotë: "O njeri, bëj atë që bën në emër të së mirës!

Diamante të paçmuara

Sepse pas kësaj dite unë nuk do të vij më. (*shi'bul Iman vëll. 3, fq. 386, Hadith 3840*)

Koha ka ikur dhe nuk kthehet më

I vdekur apo i gjallë!

Të dashur vëllezër myslimanë! Vlerësoni ditët që na janë dhënë në jetën tonë! Dhe përpikuni të bëni vepra të mira. Sepse nuk është e sigurt nëse nesër do të na thërrasin i gjallë apo i vdekur. E mendojmë apo jo, është fakt që po i afrohemi vdekjes. Ashtu siç thotë ajeti 6sureja el-Inshikak:

يَا أَيُّهَا الْإِنْسَانُ إِنَّكَ كَادِحٌ إِلَىٰ رَبِّكَ كَدًّا فَلَا يَأْتِيهِ

O ti njeri, vërtet ti përpikesh me një përpjekje të madhe që çon te Zoti yt, e atë (përpjekje) do ta gjesh.

(xhuzi 30, sureja inshikak , ajeti 6)

Vdekja vjen papritur

O njerëz që humbisni kohën tuaj të çmuar! Vetëm mendoni sa shpejt po kalon jeta!! Më shumë se një herë duhet të keni parë një burrë të shëndetshëm që vdesë papritur. Tani nuk e dimë se çfarë ka ndodhur me të në varr. Por jemi të sigurtë se ai e ka kuptuar realitetin e jetës dhe të vdekjes.

O ju që jeni të kënaqur me pasurinë e kësaj bote! O ju që grumbulloni pasuri, o ju që mendoni se qëllimi i jetës suaj

Diamante të paçmuara

është fitimi i kësaj bote! Nxitoni! Nxitoni! Përgatituni për jetën e përtejme. Zoti u ruajt! Mund të flini të qetë gjatë natës dhe të zgjoheni në një varr të errët në mëngjes. Zgjuhuni nga gjumi i pakujdesisë për hir të Allahut **عَزَّوَجَلَّ**. Në suren Enbija, ajeti 1 Allahu thotë:

اِقْتَرَبَ لِلنَّاسِ حِسَابُهُمْ وَهُمْ فِي غَفْلَةٍ مُّعْرِضُونَ ﴿١﴾

Njerëzve u është afruar koha e llogarisë së tyre, e ata të hutuar në pakujdesi, nuk përgatiten fare për të.

(xhuzi 17, sureja Enbija, ajeti 1)

Të jesh i trishtuar në xhennet!

Të dashur myslimanë! Ne duhet të kuptojmë rëndësinë e kohës sonë. Humbja e kohës sonë të çmuar është një humbje e madhe për ne. Profeti ynë **صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ** thotë; Njerëzit e xhennetit nuk do të trishtohen për asgjë, Ata do të trishtohen vetëm për kohën që kanë humbur.

(el muxhmeul kebir, vëll. 20, fq. 93-94, Hadith 172)

Lutja (dhikri) që këndojmë kur mprehim lapsin

Hafiz ibn Asakir në librin Tebjin-u-Kadhib-il-muffteri thotë: Nga dijetarët e famshëm të shekullit 5 hixhri, Selim Razi **رَحِمَهُ اللهُ عَلَيْهِ** për të vlerësuar kohën, edhe kur mprihte lapsin, vazhdonte të lutej në mënyrë që të mos humbiste kohën kot.

Diamante të paçmuara

Mbill pemë në xhennet!

Mundohuni ta shfrytëzoni mirë kohën tuaj. Kjo do të thotë që, ju mund të mbillni një pemë për veten tuaj në xhennet në një sekondë. Mënyra për të mbjellë pemë në xhennet është gjithashtu shumë e lehtë. Në një hadith në Ibën Maxhe thuhet kështu: Janë katër fjalë që, për cilëndo fjalë që të lexoni, do t'ju mbillet një pemë në xhennet.

1. سُبْحَانَ اللَّهِ
2. الْحَمْدُ لِلَّهِ
3. كَرَامَةَ اللَّهِ
4. 'اللَّهُ أَكْبَرُ'

(Suneni Ibn Maxhe , vëll. 4, fq. 252, Hadithi 3807)

Virtyti i Salavatit

Të dashur vëllezër myslimanë! Sapo keni dëgjuar se është jashtëzakonisht e lehtë të kesh një pemë të mbjellë në xhennet. Nëse thuhet një nga këto fjalë, do të mbillet një pemë, dhe nëse thuhet të katër fjalët, do të mbillen katër pemë në xhennet. Tani mund ta kuptoni më mirë rëndësinë e kohës; Pemët mund të mbillen në xhennet vetëm me një lëvizje të lehtë të gjuhës.

Nëse doni të mbillen pemë të panumërta në xhennet, në vend që të humbni kohë me biseda të kota! Qoftë në këmbë, duke ecur, ulur, shtrirë apo duke punuar, duhet të përpiqemi të

Diamante të paçmuara

këndojmë shumë salavat, sepse salavatet janë gjithashtu shumë të virtytshme. Pejgamberi ynë صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ ka thënë: “Kush më dërgon salavat një herë, Allahu عَزَّوَجَلَّ, i zbret 10 të mira, i fal 10 mëkate dhe e ngre 10 gradë. ' (Suneni Nesai, fq . 222, Ḥadithi 1294)

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

Kujtesë! Kur këndonit salavat shtrirë, këndojeni me këmbë të bashkuara.

Të dashur myslimanë! Nëse e kemi zakon t'i peshojmë fjalët përpara se të flasim në këtë mënyrë, a do t'i sjellë dobi fesë sonë apo botës sonë ajo që themi? Nëse nuk i bën dobi as fesë sonë dhe as botës sonë, atëherë duhet të këndojmë salavat ose të përpiqemi të angazhohemi në përmendjen e Allahut. Në vend që të merremi me biseda të panevojshme, duhet të përpiqemi të marrim thesarin e veprave të mira.

Ose të këndojmë këtë lutje: 'سُبْحَانَ اللَّهِ' 'الْحَمْدُ لِلَّهِ' 'لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ' 'كَرَّ اللَّهُ الْكَبِيرُ' Kështu na mbillen pemë në xhennet.

Më shumë se 60 vjet adhurim

Nëse nuk dëshiron të këndosh asgjë, mund të fitosh sevape edhe në heshtje. Në vend që të mendosh për gjëra të padobishme të kësaj bote, kujto Allahun عَزَّوَجَلَّ! Imagjino dhe mendo për Profetin e Tij të Dashur (صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ), ose diturinë islame, ose dhimbjen e vdekjes, vetminë dhe tmerrin e varrit dhe gjendjen e frikshme të ditës së gjykimit, në mënyrë

Diamante të paçmuara

që të mos humbet koha dhe çdo frymëmarrje të konsiderohet vepër e mirë!

Në Xhami-us Sagir, përmendët se Profeti ynë ka thënë: 'Një moment meditimi (për botën tjetër) është më i mirë se 60 vjet adhurim vullnetar'. (El-xhami-us-Sagir, fq. 365, Hadithi 5897)

Pesë gjëra para pesë gjërave

Të dashur vëllezër myslimanë! Sigurisht, jeta është shumë e shkurtër. Në fakt, tani është koha e vetme që kemi. Çdo shpresë për të pasur kohë në të ardhmen është vetëm një mashtrim. Mundet që në momentin tjetër të takojmë vdekjen tonë.

Rasulull-llahu ﷺ ka thënë:

اِغْتَنِمْ خَمْسًا قَبْلَ خَمْسٍ: شَبَابَكَ قَبْلَ هَرَمِكَ وَصِحَّتَكَ قَبْلَ سَقَمِكَ
وَغِنَاكَ قَبْلَ فَقْرِكَ وَفَرَاحَكَ قَبْلَ شُغْلِكَ وَحَيَاتَكَ قَبْلَ مَوْتِكَ

Përkthimi: Përpara se të vijë 5 gjëra, vlerësoni këto 5 gjëra: (1) rininë para pleqërisë, (2) shëndetin para sëmundjes, (3) pasurinë para varfërisë, (4) kohën e lirë para se të jeni të zënë dhe (5) jetën para vdekjes .

(El-Mustedrek, vëll. 5, fq. 435, Hadithi 7916)

Dy mirësi

Profeti ynë i dashur صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ, ka thënë: “Ka dy mirësi që shumica e njerëzve mashtrohen duke ditur vlerën e tyre. Njëra është shëndeti dhe e dyta koha e lirë. (Sahih Bukhari, vëll. 4, fq. 222, Hadithi 6412)

Të dashur vëllezër myslimanë! Pa dyshim, një i sëmurë mund ta kuptojë rëndësinë e shëndetit më mirë se një person i shëndetshëm. Po kështu, një person tepër i zënë e di rëndësinë e kohës. Ata që humbin kohën e tyre nuk e kuptojnë rëndësinë e këtyre momenteve të çmuara. Mund ta vlerësoni kohën tuaj dhe ta shfrytëzoni sa më mirë duke shmangur takimet e panevojshme, aktivitetet e kota dhe shoqërinë e padobishme të miqve tuaj.

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

Bukuritë e Islamit

Në një hadith në Tirmidhi: Profeti ynë i dashur صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ, ka thënë: 'Një nga bukuritë e Islamit është se i pengon njerëzit të bëjnë gjëra të kota.' (Sunen-et-Tirmidhi, vëll. 4, fq. 142, Hadithi 2344)

Vlera e momenteve të paçmuara

Të dashur vëllezër myslimanë! Jeta përbëhet nga dita, orë dhe momente të kufizuara. Çdo frymëmarrje është një diamant i paçmuar. Uroj të vlerësojmë çdo frymëmarrje dhe të kalojmë

Diamante të paçmuara

çdo moment duke bërë vepra të mira! Nëse nuk e humbim kohën në aktivitete të padobishme dhe mëkatore, nëse e gjejmë librin tonë të zbrazët nga veprat e mira, mund të na duhet të kthehemi me trishtim dhe keqardhje në Ditën e Gjykimit. Nëse do të mendonim se si e kalojmë çdo moment të jetës sonë. Do të përpiqeshim të kalonim çdo moment të jetës sonë në aktivitete të dobishme, duke mos i harxhuar ato me biseda të panevojshme dhe thashetheme të kota. Përndryshe, do të pendohemi në ditën e gjykimit. Uroj që ne të mund të llogarisim çdo sekondë dhe ta përdorim atë për fenë tonë.

Çfarë thonë ata që vlerësojnë kohën

1. Emir-ul-Mu'minin Hazreti Aliu **كَرَّمَ اللَّهُ وَجْهَهُ الْكَرِيمِ** ka thënë: "Këto ditë janë faqet e jetës suaj, zbukurojini me vepra të mira.
2. Hazreti Abdullah bin Mesud **رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ** ka thënë: "Ndihem shumë i trishtuar dhe i turpëruar për ditët që kalova para se të shtoja veprat e mia të mira."
3. Hazreti Omer bin Abdul Aziz **رَحِمَهُ اللَّهُ عَلَيْهِ** thotë: "Jeta jote po pakësohet dita-ditës, pra pse je përtac në kryerjen e veprave të mira?" Një ditë, një person kur i tha për një punë: "O komandanti i besimtarëve! Duhet ta shtyni këtë punë për nesër." Ai **رَحِمَهُ اللَّهُ عَلَيْهِ** tha, 'Vështirë se mund ta kryej një punë brenda një dite; Nëse e shtyj punën e sotme për nesër, si mund të kryej dy punë në një ditë?

Punën e sotme mos e lini për nesër, nesër do të gjeni një punë tjetër.

4. Hazreti Hasan Basriu رَحْمَةُ اللَّهِ عَلَيْهِ thotë: “O njeri! Jeta jote përbëhet nga ditët. 'Kur kalon një ditë, kalon edhe një pjesë e jetës sate.' (*tabakat-ul-Kubrā lil-manevi*, vëll. 1, fq. 259)
5. Imam Shafiu رَحْمَةُ اللَّهِ عَلَيْهِ ka thënë: “Kam qëndruar me miqtë e Allahut për një periudhë të caktuar kohe dhe kam arritur përfitime shpirtërore. Nga këto mësova dy gjëra të rëndësishme:
 - i. Koha na pret jetën si një shpatë e mprehtë. Jini të zënë me vepra të mira që koha e kaluar të kalojë mirë. Përndryshe, duke harxhuar kohën kot, koha do na presë si një shpatë e mprehtë dhe koha na humbet.
 - ii. Ruani veten (nefsin) tuaj; Nëse nuk e mbani të zënë me gjëra të mira, ai do të jetë i zënë me gjëra të këqija.'
6. Imam Razi رَحْمَةُ اللَّهِ عَلَيْهِ ka thënë, Beto hem në Allahun عَزَّوَجَلَّ Ndi hem shumë i trishtuar kur ha, sepse më duhet të heq dorë nga aktivitetet fetare (të shkruarit ose të lexuarit). 'Koha është një thesar shumë i vlefshëm.'
7. Hafiz Ibn Haxher رَحْمَةُ اللَّهِ عَلَيْهِ për Hazreti Shemseddin Esbahanin رَحْمَةُ اللَّهِ عَلَيْهِ thotë. Një dijetar i madh shafi'i i shekullit): Ai رَحْمَةُ اللَّهِ عَلَيْهِ hante më pak për të shmangur

Diamante të paçmuara

humbjen e kohës që shkonte në tualet shpesh. (*Ad-Dur-rul-Kāminah lil-'Asqalānī, vëll. 4, fq. 328*)

8. Al-lame Dhehebiu رَحْمَةُ اللهِ عَلَيْهِ shkruan në Tedhkirat-ul Huffadh për Hatibi Bagdadin رَحْمَةُ اللهِ عَلَيْهِ; “Ai رَحْمَةُ اللهِ عَلَيْهِ lexonte libra edhe duke ecur rrugës për të shfrytëzuar kohën që të mos humbiste koha e shkuarjes dhe e ardhjes. (*Tazkira-tul-Huffāz, vëll. 3, fq. 224*)
9. Hazret Xhunejd Bagdadi رَحْمَةُ اللهِ عَلَيْهِ ishte duke lexuar Kuran në momentin e vdekjes së tij. Dikush e pyeti i habitur: “A po lexoni edhe në këtë gjendje!” Ai رَحْمَةُ اللهِ عَلَيْهِ tha: “Libri im i veprave po mbyllet, kështu unë po shtoj vepra të mira në mënyrë të shpejtë. (*Şīd-ul-Hatur li Ibn-ul-Jauzī, fq. 227*)

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

Bëni një plan kohor

Të dashur vëllezër dhe motra! Nëse është e mundur, bëni një plan ditor. Para të gjithash, përpiquni të flini brenda dy orëve pas namazit të jacisë. Biseda me miqtë gjatë natës (nëse nuk ka ndonjë përfitim fetar), thashetheme me miqtë, shoqërimi në klube, etj. Është një humbje e madhe. Në Tefsirin Ruhul-Beyan, vëllimi 4, faqe 166, thuhet si vijon: 'Një nga arsyet pse populli i Lutit u shkatërrua ishte sepse ata ishin ulur buzë rrugës dhe qeshnin e bënin shaka.'

Diamante të paçmuara

Të dashur myslimanë! Dridhuni nga frika e Allahut **عَزَّوَجَلَّ**! Pavarësisht se sa fetarë janë miqtë tuaj, shmangni gjëra të tilla që ju largojnë nga Zoti dhe pendohuni! Pasi të keni kryer aktivitetet tuaja fetare gjatë natës, shkoni në shtrat herët, sepse pushimi i natës është më i mirë dhe më i natyrshëm sesa pushimi gjatë ditës. Në suren Kasas, ajeti 73 thuhet:

وَمِنْ رَحْمَتِهِ جَعَلَ لَكُمْ اللَّيْلَ وَالنَّهَارَ لِتَسْكُنُوا فِيهِ وَلِتَبْتَغُوا مِنْ
فَضْلِهِ وَلَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ

“Po mëshira e Tij u bëri juve natën dhe ditën për të pushuar në të dhe për të përfitur nga begatitë e Tij, prandaj, të jini mirënjohës!”

(xhuzi 20, sureja Kasas, ajeti 73)

Lidhur me interpretimin e këtij ajeti, Myftiu Hākim-ul-Ummet Aḥmad Yār Khan **رَحْمَةُ اللهِ عَلَيْهِ** shkroi në faqen 629 të Nûr-ul'Irfân: "Në këtë ajet tregon qartë se është më mirë të pushosh natën dhe të punosh për të siguruar jetesën gjatë ditës.. Mos rrini zgjuar natën pa nevojë, mos e humbni ditën kot. Mirëpo, nëse dikush fle gjatë ditës dhe punon gjithë natën për shkak të punës së tij, nuk ka të keqe ta bëjë këtë."

Mirësitë e Mëngjesit

Është e rëndësishme të merrni parasysh natyrën e punës tuaj kur e planifikoni atë. Për shembull, vëllezërit myslimanë që

Diamante të paçmuara

flenë herët në darkë do të jenë energjikë në mëngjes. Prandaj, orët e mëngjesit janë shumë të mira për punët. Profeti Muhamed ﷺ, tha lutjen e mëposhtme e cila është përmendur në Tirmidhi: 'O Allah ﷺ umetit tim jepi të mira në mëngjes'. (*Sunen-ut-Tirmidhi, vëll. 3, fq. 6, Hadithi 1216*)

Lidhur me këtë hadith, myftiu Ahmed Yār Khan رَحْمَةُ اللَّهِ عَلَيْهِ thotë: Ky hadith do të thotë “ (O Allah ﷺ) bekoje umetin tim në të gjitha punët fetare dhe të kësaj bote që i bëjnë në mëngjes.. (Për shembull: udhëtimi, dituria, puna, etj.).' (*Mirāt-ul Manājih, vëll. 5, fq. 491*)

Mundohuni të planifikoni orarin tuaj siç duhet nga momenti kur zgjoheni në mëngjes deri në kohën kur shkoni për të fjetur në darkë. Për shembull, namazi i tehexhudit, që ka të bëjë me diturinë, namazi i sabahut me tekbirin e parë në xhami, ishtraku, mëngjesi, paradija, puna, dreka dhe punët e shtëpisë, puna e mbrëmjes, biseda të drejta (nëse nuk ka bisedë të mirë, është më e mirë të ulësh vetëm).

Të gjitha këto aktivitete duhet të përfundojnë dhe t'u jepet koha e duhur. Ata që nuk janë mësuar ta bëjnë këtë mund të kenë vështirësi në fillim, por gradualisht bëhet zakon dhe i shohin vetë mirësitë, إِنَّ شَاءَ اللَّهُ ﷺ

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللَّهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

Të dashur myslimanë! Tani do të flas për disa virtyte të Sunetit. Pejgamberi ynë ﷺ, i cili është shumë i mëshirshëm

Diamante të paçmuara

me umetin e tij, thotë: "Kushdo që e ringjall sunetin tim (jeton - e mban të gjallë atë), ai me siguri më ka dashur mua dhe kush më do mua, unë do të jem bashkë me të në xhennet."

(Miskāt-ul-Maṣābīh, vëll. 1, fq. 55, Ḥadithi 175)

15 Lule të bukura lidhur me gjumin

1. Shkundni dyshekun tuaj tërësisht përpara përdorimit për të hequr çdo krijesë dëmtuese.
2. Lexoni lutjen e mëposhtme para se të flini:

اللَّهُمَّ بِاسْمِكَ أَمُوتُ وَأَحْيَى

Përkthimi: O Zoti im عَزَّوَجَلَّ! Unë vdes dhe ringjallem me emrin tënd..

(Sahihi Buhari, vëll . 4, fq . 196, Ḥadithi 6325)

3. Njeriu që fle pas namazit të ikindisë do të ketë mendje të dobët. Pejgamberi ynë صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ, thotë: "Kushdo që fle pas namazit të ikindisë dhe ka probleme në mendjen e tij, le të fajësojë vetëm veten e tij. *(Musned Ebi Ja'la, vëll. 4, fq. 278, Ḥadithi 4897)*
4. Rekomandohet të flini pas dreke. *(Fatāwā 'Ālamgīrī, vëll. 5, fq. 376)* Sadr-us Sheriat, Badr-uṭ-Ṭariqah 'Al-lame Mevlana Mufti Muhammad Amxhed 'Ali Azmi رَحِمَهُ اللهُ عَلَيْهِ ka thënë, "Kjo është një kompensim për ata që adhurojnë

Diamante të paçmuara

na vrau. Ringjallja pas vdekjes do të jenë gjithashtu në praninë e Allahut.

(Sahih Buhari, vëll. 4, fq. 196, Hadithi 6325)

11. Kur të zgjoheni, synoni të jeni një mysliman i mirë dhe të mos dëmtoni askënd.

(Fatāwā 'Ālamgīrī, vëll. 5, fq. 376)

12. Kur vajzat dhe djemtë mbushin 10 vjeç, ata duhet të flenë në shtretër të veçantë. Kur një djalë arrin këtë moshë, ai nuk duhet të flejë më me moshatarët e tij ose me dikë tjetër. *(Durr-ul muhtar , vëll. 9, fq. 629)*

13. Nëse burri dhe gruaja flenë në të njëjtin shtrat, nuk duhet të lejojnë një fëmijë dhjetëvjeçar të flejë me ta. Kur një mashkull arrin pubertetin, ai konsiderohet i rritur. *(Durr-ul muhtar, vëll. 9, fq. 630)*

14. Përdorni Misvak (për të pastruar dhëmbët) kur të zgjoheni.

15. Është një virtyt i madh të ngrihesh për namazin e tehexhudit gjatë natës.

Profeti ynë fytyrë ndritur ﷺ ka thënë: "Pas namazit

Diamante të paçmuara

farz, namazi më i mirë është namazi i natës (tehaxhudit)".

(Sahih Muslim, fq. 591, Hadithi 1163)

Për të mësuar mijëra sunete, merrni dhe lexoni dy librat e botuar nga Mektebetul Medina, "Bahar-i Sheria" kapitulli 16 (312 faqe) dhe librin 120 faqesh "Sunetet dhe mirësjelljet". Mënyra më e mirë për të trajnuar sunetet është të udhëtoni plot sunet me dashamirët e Profetit në kolonat e Thirrjes Islame.

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللَّهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

Pasi ta lexoni këtë libër, jepjani dikujt tjetër

Bëni vepra të mira duke shpërndarë këto fletushka të vlefshme për thesarin e shtypur nga 'Mektebetul Medina' kur mblidheni në ceremoni të lumtura si dasma ose ditëlindje, ose në ditë të dhimbshme. Bëjeni zakon t'i mbani në dyqanin tuaj për t'i bërë dhurata klientëve tuaj. Ftojini ata në vepra të mira duke i shpërndarë nëpër shtëpi të paktën një herë në muaj përmes, shpërndarësve të gazetave ose fëmijëve dhe merrni pjesën tuaj nga kjo vepër e mirë.

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللَّهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

PËR T'U BËRË MYSLIMAN
FETAR DHE NAMAZ FALES

Kaloni gjithë natën me qëllime të mira për hir të Allahut غَزْوَجَل نē takimin javor të Frymëzuar nga Sunneti nē Daveti-Islami që mbahet çdo të enjte pas namazit nē qytetin tuaj. Për të mësuar Sunetet, bëjeni zakon tuajin të udhëtoni me besimtarët dhe të përkushtuarit e të Dërguarit për 3 ditë çdo muaj me një grup Medeni, praktikoni Fikr-i Medine çdo ditë, plotësoni broshurën e veprave fetare dhe ia dorëzoni atë vëllait mysliman i cili është përgjegjës nē zonën tuaj nē datën e parë të çdo muaji.

Qëllimi im Medeni: Unë duhet të përpiqem të reformoj veten dhe të gjithë njerëzit e botës **بِنِ شَاتَالِه غَزْوَجَل** Për të reformuar veten, ne duhet të veprojmë me devotshmëri dhe të përpiqemi për të reformuar të gjithë njerëzit e botës, ne duhet të udhëtojmë me grupet Madani **بِنِ شَاتَالِه غَزْوَجَل**.



Aalami Madani Markaz, Faizan-e-Madinah, Mahallah Saudagaran
Purani Sabzi Mandi, Bab-ul-Madinah, Karachi, Pakistan.

UAN: +92 21 111 25 26 92 | Ext: 1262

Web: www.dawateislami.net | E-mail: translation@dawateislami.net